

Forenzike me datë 23.08.2021, i ka kthyer përgjigje ankuesit ne kërkesën e parashtruar te datës 05.08.2021, përmes se cilës i ka refuzuar pretendimet ankimore te ankuesit.

Ankuesi me datë 17.09.2021 ka pashtuar ankesë në Këshillin të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që organi i punësimit të përmbush detyrimin e pagesës se mjeteve monetare duke i kompensuar ankuesit për dhjetë vite 50% të pagës si dhe të vazhdoj kompensimin e rregullt për vitet në vijim sipas Ligjit me Nr.04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 20.09.2021 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, ndërsa Këshilli, me datë 29.09.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje, me datë 01.11.2021, përmes shkresës me numër protokolli 5218/2021 ka njoftuar ankuesin lidhur me rrethanat e krijuara e të cilat kanë pamundësuar shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.816/2021 të datës 17.09.2021 dhe të njëjtin e ka udhëzuar për ushtrimin e mjeteve juridike në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 05.07.2023 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.2971/2021 përmes se cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 01.11.2021 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën me numër A.nr.816/2021 të datës 17.09.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Aktgjykimin e datës 28.07.2023; Njoftimin me numër të protokollit 5218/2021 të datës 01.11.2021; Ankesën me numër të protokollit 4667/2021 të datës 17.09.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 05.08.2021; Kërkesën e datës 05.08.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër te protokollit 4807/2021 të datës 20.09.2021; Kontratën e Punës për Kohë të pacaktuar; Përgjigjen në kërkesë të datës 29.09.2021; Udhëzimin administrativ me numër 32/2012-MPB; Formulari i Vlerësimit të Punës (pa date dhe numër); Udhëzuesin për kriteret e notimit; Emalin e datës 10.06.2021 nga info.dmzp për _____ për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publike; Listën e Zyrtareve Publike te Agjencisë së Kosovës për Forenzikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar provat e lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Kontratës së Punës për Kohë të pacaktuar të datës 22.07.2013 ankuesi mban pozitën "Specialist i Lartë në Divizionin e Balistikës" në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, ndërsa Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të emalit të datës 10.06.2021 nga info.dmzp lidhur me Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve

Publikë të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, si dhe listës së bashkangjitur të Zyrtareve Publike të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, konstaton që statusi i ankuesit është konfirmuar *"Nëpunësi i Shërbimit Publikë"*.

Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, konkretisht neni 2 ka paraparë fushëveprimin, ku përcaktohet se: *"AKF-ja është institucioni përgjegjës për ofrimin e paanshëm, të analizave objektive shkencore forenzike"*, ndërsa neni 5 përcakton misionin e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, ku përcaktohet se: *"Misioni i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë është që përmes ushtrimit të veprimtarisë së saj, të ofroj shërbime forenzike cilësore në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet vendore dhe ndërkombëtare"*. Lidhur me personelin e punësuar në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, neni 17 i Ligjit Nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, ka bërë ndarjen në tri kategori si: *"1.1. personeli i specializuar- shkencor; 1.2. personeli mbështetës; 1.3. pozitat ekzekutive"*. Pozita që mban ankuesi *"Specialiste e Lartë në Divizionin e Balistikës"*, hyn në kuadër të kategorisë *personeli i specializuar- shkencor*, ndërsa sipas nenit 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, është përcaktuar se: *"Personel i specializuar shkencor - punonjësi i specializuar teknik dhe menaxhues që kryejnë, udhëheqin apo verifikojnë ekspertimet kriminalistike, si dhe asistojnë në shikimin apo rikonstruimin e vendit të ngjarjes"*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në kuptim të pranushmërisë së ankesës ju referua dispozitave të Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtar Publik përkatësisht neni 2 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se zyrtarët publikë janë ndarë në: nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); nëpunësi i Shërbimit Publik; nëpunësi i Kabinetit; dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës, në kuadër të kësaj pozita që mban ankuesi, hyn në kuadër të zyrtarëve publik si nëpunësi i shërbimit publikë, siç parashihet me paragrafin 4 të nenit 2 të këtij ligji, i cili përcakton që: *"Nëpunësi i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtëpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike"*, ndërsa marrëdhënia e punës e nëpunësit shërbimit publik është trajtuar në pjesës V të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht neni 64 paragrafi 1 i këtij ligji, ka përcaktuar që: *"Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të Ligjit, marrëdhënia e punësimit për nëpunësin e Shërbimit Publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit të Punës"*, rrjedhimisht, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në Kontratën e Punës se ankuesit (të datës 23.07.2013) sipas të cilës ankuesi ka themeluar marrëdhënie të punës me Agjencinë e Kosovës për Forenzikë mbi bazën e Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Kolegji i Këshillit konstatoi se pozita e punës së ankuesit *"Specialist i Lartë në Divizionin e Balistikës"* në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, nuk hyn në kategorinë e nëpunësve civil por e njëjta hyn në kategorinë e nëpunësve të Shërbimit Publik, e që rrjedhimisht ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil për t'ju shqyrtuar ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës .

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civilë si dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesi e ka te

konfirmuar statusin e nëpunësit të shërbimit publikë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.816/2021 të datës 17.09.2021, të parashtruar nga ankuesi.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, thekson se "*Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe Nëpunësi Administrativ dhe Mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në Gjykatën kompetente*", nenin 74 paragrafi 1, i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik është përcaktuar se, "*Zyrtari i shërbimit publik mund të ankohet te punëdhënësi kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës. Të drejtën e ankimit e kanë dhe kandidatët në procedurën e konkurrimit*" ndërsa paragrafi 3 përcakton se, "*Shqyrtimi i ankesave është në kompetencën e Komisionit të Ankesave. Komisioni i Ankesave krijohet: 3.1. në çdo administratë të institucionit të shërbimit publik; 3.2. në çdo ministri për administratën e njësisë të Shërbimit Publik në kompetencë të administratës shtetërore; dhe 3.3. në çdo komunë për nëpunësit e administratës së njësisë së shërbimit publik në kompetencë të komunës*". Andaj në këtë kuptim nëpunësit e Shërbimit Publik fillimisht duhet të ankohen te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në Gjykatën kompetente.

Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenin 6 paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli nuk është kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.816/2021 të datës 17.09.2021 të parashtruar nga ankuesi sepse Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në Shërbim Civil

Marrë parasysh konstatimin si me lartë, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.816/2021 të datës 17.09.2021 dhe meqë nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesi nuk e ka shfrytëzuar mjetin e rregullt juridik pranë organit kompetent, Kolegji për Shqyrtim dhe Vendosje të Ankesave duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit të Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në kuptim të nenit 64 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ku është përcaktuar se "*Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të Ligjit, marrëdhënia e punësimit për nëpunësin e Shërbimit Publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit të Punës*", dhe pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 24 paragrafi 4 ku theksohet se: "*Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe Nëpunësi Administrativ dhe Mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në Gjykatën kompetente*".

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe në nenin 18

paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.816/2021

Ilire **MEHMETI-SHAQIRI**

Procesmbajtëse

Malsore **GASHI-BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Gjyqtarës Luljeta Maxhuni, Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative
- Kryeshefit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë se Kosovës për Forenzikë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së